



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE
PASUNIVERSITARE NË GREQI, VITI AKADEMIK 2017-2018**

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Greqisë shpall Programin e Bursave për studime universitare dhe pasuniversitare për studentët e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në Greqi, për vitin akademik 2017-2018.

Kandidatët e interesuar për studime universitare/ pasuniversitare ose doktoraturë, të cilët nuk e njohin gjuhën greke, do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të kësaj gjuhe për një vit akademik, i cili fillon në shtator të vitit 2017.

Formularët e aplikimit dhe materialet informativë për këto bursa studimi, ku përfshihet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësojnë kandidatët, ndodhen bashkëlidhur këtij njoftimi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës direkt pranë Ambasadës Greke në Tiranë ose pranë Konsullatës së Përgjithshme Greke në Gjirokastrë/Korçë, brenda datës **25 korrik 2017** që është edhe afati fundit për aplikim.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE